



REPAIR MORTAR

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
Grë	Thes 25 kg	1.8 kg/m ² /mm trashësi



PËRSHKRIM

Llaç riparues i parapregatitur me bazë çimentoje, i përforcuar me fibra dhe aditive të modifikuar për për-dorim në ambiente të brendshme dhe të jashtme. Ofron :

- Rezistencë të lartë mekanike.
- Punueshmëri e lehtë.
- Nuk tkurret , nuk krijon plasaritje dhe nuk rrëshket në trashësi të mëdha (3- 6 cm).
- Rezistent ndaj temperaturave ekstreme dhe abrazionit.
- Rezistencë të lartë ndaj lagështisë. -Ngjitje shumë të mirë me suportin. Klasifikohet si llaç PCC R3 për riparime betoni, sipas EN 1504-3.

FUSHA E APLIKIMIT

Llaçi riparues është i përshtatshëm për mbushjen dhe ristrukturimin e pjesëve të dëmtuara të betonit ,për punime të ndryshme hidraulike , rreg-ullimin e pjesëve të thyera dhe të dëmtuara në dysheme ,mure , shkallë e kollona. Aplikimi bëhet vetëm me një dorë dhe punimet rekomandohen të bëhen në temperature nga +5 deri në +35 °C.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti para aplikimit të Llaçit Riparues duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra, bojra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Para aplikimit bazamenti duhet lagur me ujë. Nëse struktura e dëmtuar ka pjesë të paqendrueshme dhe të lira , duhet të hiqen sepse behën pengesë në ngjitje.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Përziejmë 5.5 l ujë të pastër me 25 kg produkt, masa e krijuar rekoman-dohet të përziejhet me një përzieres elektrik derisa të formohet një masë homogjene. Masa e krijuar lihet në qetësi për 5 minuta dhe rekoman-dohet të përziejhet përsëri përpara për-dorimit. Produkti aplikohet vetëm me një shtresë. Trashësia e shtresës nga 3-6 mm. Aplikimi mund të bëhet me mistri ose makineri.



Kujdes!

Bazamenti para aplikimit të Llaçit Riparues duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra, bojra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Para aplikimit bazamenti duhet lagur me ujë. Nëse struktura e dëmtuar ka pjesë të paqendrueshme dhe të lira, duhet të hiqen sepse behën pengesë në ngjitje.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 25 kg
Ngjyra:	Gri
Kokrrizimi:	1.2 mm
Konsumi:	1.8kg /m ² /mm trashësi
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Masa vëllimore e llaçit të thatë:	1.6-1.7gr/cm ³
Trashësia maksimale e aplikimit :	60mm
Koha e punueshmërisë së produktit:	2 orë
Ujë për përzierjen:	5.5 lit/thes
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Rezistenca në shtypje:	≥ 25N/mm ²
Forca ngjitëse pas në beton:	≥1.5 N/mm ²
Shtresa e aplikimit:	Me një dorë
Konsumi:	17-19 kg/m ² /cm trashësi